



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201301252/8

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandohet ushtrimi i funksioneve sikurse parashikuar në nenin 7, 8 të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor", në procesin e ekzekutimit nga Zyra e Përmbarrimit, Tiranë, të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 6531, datë 13.09.2010 të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.*

Drejtuar : **Albert Pilo**
Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarrimit
Gjyqësor
Adresa: Rruga e "Kavajës"

TIRANE

Z.Drejtor i Përgjithshëm!

Prej muajit Qershor 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka në proces shqyrtimi ankesën e shtetas L.N, në të cilën ajo ka prezantuar shqetësimin për moszekutimin prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.6531, datë 13.09.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1802, datë 15.09.2011, me objekt :

"Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. 7187/1016, date 18.09.2007 të hartuar ndërmjet pales shitëse, Shoqërisë "PF Trade Tiranë" sh.p.k. dhe palës blerëse I.D.

Detyrimin e Shoqërisë "PF" sh.p.k. të lidh kontratë shitje të pasurisë të paluajtshme me paditësen Lutfije Nexhipi në përputhje me kontratën e porosisë nr. 2502 rep, date 04.05.2004.

Detyrimin e ZVRPP, Tiranë, të bëj ç'regjistrimin e pasurisë nr.5/266+1-2 e ndodhur, Zona Kadastrale 8130, me sipërfaqe 34.25m2 të të paditurit I.D....."

Qëndrimi i Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, në marrëdhënien me Institucionin e Avokatit të Popullit për këtë çështje, ka qënë dhe mbetet i parregullt për shkak të mosrespektimit nga ana e këtij organi të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit sipas përmbajtjes së saj si dhe mosdhënies së informacionit në afatin ligjor prej 30 ditëve të bërë me dije.

Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti është kërkuar në mënyrë të përsëritur me shkresat nr. K2/L15-2 Prot, datë 03.06.2013, nr.K2/L15-4 Prot, datë 18.07.2013, nr.K2/L15-5 Prot, datë 05.11.2012, nr.K2/L15-6 Prot, datë 31.01.2014, Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, përmbarruesit gjyqësor të çështjes, organit që ju përfaqësoni, dhënia e informacionit sikurse përcaktuar në shkresat e sipërpërmendura.

Pas kërkimit për herë të katërt të informacionit dhe shpjegimeve, Zyra e Përmbarrimit, Tiranë, me shkresën nr. 1896 Prot, date 10.03.2014, bënë me dije se ka kryer me shkresën nr.6534, date 02.12.2013, lajmërimin e palës debitore për ekzekutimin vullnetar të detyrimit si dhe kërkuar me shkresën nr.7138, datë 19.12.2013, ZVRPP, Tiranë, kryerjen e veprimeve për . ç' regjistrimin e pasurisë nr.5/266+1-2 e ndodhur, Zona Kadastrale 8130, me sipërfaqe 34.25m² të të paditurit Ilirjan Dorëzi.

Në qëndrimin e shprehur prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, nuk informohet se kur është bërë e mundur pranimi i kërkesës së gjyqfitueses L.N. për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv të lartpërmendur për të cilin është lëshuar dhe urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr.7628, datë 22.12.2011 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Referuar informacionit të dhënë prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, si dhe deklarimeve të kryera prej ankueses, çështja përmbarrimore prej afro një viti nga data e vënies në ekzekutim është kaluar për kryerje veprimesh nga përmbarruesi gjyqësor Medar Kajolli tek përmbarruesja gjyqësore Suana Kondi dhe së fundmi tek përmbarruesi gjyqësor Pjetër Caka. Pra, përgjatë kësaj periudhe prej përmbarruesve gjyqësor që kanë pasur për ndjekje rastin në fjalë janë kryer vetëm veprimet përmbarrimore si më sipër bërë më ditur. Veprimi i kërkimit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, me shkresën nr.7138, datë 19.12.2013, prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, referuar deklarimeve të ankueses rezultoi i panevojshëm pasi është kryer përmbushja e detyrimit për ç' regjistrimin e pasurisë nr.5/266+1-2 e ndodhur, Zona Kadastrale 8130, me sipërfaqe 34.25m² të të paditurit I.D. Ankuesja ka kërkuar dhe kërkon mundësimin e kryerjes së veprimeve përmbarrimore të cilat mundësojnë ekzekutimin e detyrimit të Shoqërisë "PF" sh.p.k. të lidh kontratë shitje të pasurisë të paluajtshme me paditësen L.N. në përputhje me kontratën e porosisë nr. 2502 rep, date 04.05.2004. Për përmbushjen e këtij detyrimi rezultoi se, Zyra e Përmbarrimit, Tiranë, përmbarruesi gjyqësor i çështjes nuk ka kryer dhe nuk kryen veprimet përmbarrimore sikurse parashikuar në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile, duke cënuar në këtë mënyrë parimin e sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 6/1 të Konvetës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të titullit ekzekutiv në afat.

Pa asnjë shkak të prezantuar, konstatohet se, Zyra e Përmbarrimit, Tiranë, përmbarruesi gjyqësor i çështjes nuk kryen veprimet përmbarrimore sikurse parashikuar në nenin 606 të K.Pr.C., qëndrim i cili vjen në kundërshtim me parimin e zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me ligjin, kryerjen me objektivitet të kësaj veprimtarie si dhe në respektim të të drejtave të garantuar me ligj subjektit gjyqfitues i cili merr pjesë në ekzekutim.

Duke e vlerësuar të parregullt veprimtarinë e Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.6531, datë 13.09.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si dhe në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të lartpërmendur, Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të parashikimit të nenit

63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”, si dhe nenin 21/b, të Ligjit nr.8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJMË

Ushtrimin e funksioneve sikurse parashikuar në nenin 7, 8 të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor”, në procesin e ekzekutimit nga Zyra e Përmbarrimit, Tiranë, të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 6531, datë 13.09.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në favor të L.N.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Shkresë nr.K2/L15-2 Prot, datë 03.06.2013, të Avokatit të Popullit drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë.

Shkresë nr.K2/L15-4 Prot, datë 18.07.2013, të Avokatit të Popullit drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

Shkresë nr.K2/L15-5 Prot, datë 05.11.2012, të Avokatit të Popullit drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë.

Shkresë nr.K2/L15-6 Prot, datë 31.01.2014, të Avokatit të Popullit drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

Shkresë nr. 1896 Prot, date 10.03.2014, të Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi

ND/KOMISIONER

Frederik PASKALI

